

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“Adriatic Luxury Hotels” SHPK**

Sot më Datë 06 . 06 .2023, themelohet Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Adriatic Luxury Hotels”, sipas parashikimeve të këtij Akt Themelimi.

**NENI 1
Emërtimi i Shoqërisë**

- 1.1 Themelohet Shoqëria “Adriatic Luxury Hotels”.
- 1.2 Shoqëria organizohet në formën e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar.

**NENI 2
Themeluesit**

2.1 Ortak Themelues të Shoqërisë “Adriatic Luxury Hotels” Shpk janë:

a) Shoqëria “Met Invest” Shpk, me NIPT L81310039M, me Seli në Adresën Rruga “Ismail Qemali”, Pallati 11, Kati 2, Tiranë, me Administrator Z.Hauard Malo, Shtetas Shqiptar, i biri i Muhametit, lindur më 23.12.1995 në Tiranë dhe banues po aty, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Pasaportës me Nr.BB9441725 dhe Nr.Personal J512230470;

b) Shoqëria “Albanian Investment Construction” Shpk, me NIPT K51920007Q, me Seli në Adresën Tiranë, Rruga “Ndre Mjeda”, Ndërtesa 31, Hyrja Nr.5, Zyra Nr.1, Njësia Bashkiake Nr.7, Kodi Postar 1023, Përfaqësuar nga Administratori Z.Alban Peza, Shtetas Shqiptar, lindur më 25.08.1970 në Tiranë dhe banues po aty, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Letërnjoftimit ID me Nr.037062716 dhe Nr.Personal H00825199V.

c) Shoqëria “K & R” Shpk, me NIPT L83509801D, me Seli në Adresën Kavajë, Rruga “Egnatia”, Zona Kadastrale 8551, Nr.Pasurie 1/558, përfaqësuar nga Administratori Z.Osman Kokoshi, Shtetas Shqiptar, lindur më 27.05.1969, mbajtës i Letërnjoftimit ID me Nr.033458705 dhe Nr.Personal G90527037M.

2.2 Themelimi i Shoqërisë “Adriatic Luxury Hotels” Shpk dhe autorizimi i Administratorëve të Personave Juridik themelues për të nënshkruar aktet e themelimit, bazohet në aktet e mëposhtme:

- a) Në Vendimin Nr. 30 , Datë 01 . 06 .2023 të Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë “Met Invest” Shpk;
- b) Në Vendimin Nr. 3 , Datë 31 . 05 .2023 të Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë “Albanian Investment Construction” Shpk;
- c) Në Vendimin Nr. 5 , Datë 02 . 06 .2023 të Ortakut të Vetëm të Shoqërisë “K & R” Shpk;

**NENI 3
Selia e Shoqërisë**

3.1 Selia e Shoqërisë do të jetë në Tiranë, Rruga "Ismail Qemali", Pallati 11, Kati 2, Tiranë.

3.2 Shoqëria, në kuadër të ushtrimit të aktivitetit të saj tregtar, ka të drejtë të hapi adresa sekondare në të gjithë territorin e vendit.

NENI 4 Kohëzgjatja e Veprimtarisë

4.1 Shoqëria do të ushtroj veprimtarinë e saj për një afat kohor të pakufizuar.

NENI 5 Objekti i Veprimtarisë

- 5.1 Shoqëria do të operojë në fushat e mëposhtme:
- Operimi i Hoteleve, Resorteve Turistike dhe Strukturave të tjera të Akodimit dhe Turizimit.
 - Operimi i Bar-Restoranteve;

NENI 6 Kapitali

6.1 Kapitali i Shoqërisë është 100,000 (njëqind mijë) Lekë.

6.2 Kapitali i Shoqërisë përbëhet nga tre kuota, të zotëruara nga Ortakët Themelues në raportet e mëposhtme:

- Shoqëria "Met Invest" Shpk, zotëron një kuotë e cila përfaqëson 33 % (tridhjetë e tre përqind) të Kapitalit të Regjistruar të Shoqërisë, e barabartë me 33,000 (tridhjetë e tre mijë) Lekë.
- Shoqëria "Albanian Investment Construction" Shpk, zotëron një kuotë e cila përfaqëson 33 % (tridhjetë e tre përqind) të Kapitalit të Regjistruar të Shoqërisë, e barabartë me 33,000 (tridhjetë e tre mijë) Lekë.
- Shoqëria "K & R" Shpk, zotëron një kuotë e cila përfaqëson 34 % (tridhjetë e katër përqind) të Kapitalit të Regjistruar të Shoqërisë, e barabartë me 34,000 (tridhjetë e katër mijë) Lekë.

6.3 Vlera e kontributit të Ortakëve Themelues në Kapitalin të Regjistruar, është në para dhe do të shlyhet brenda 3 muajsh, nga dita e regjistrimit të Shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

NENI 7 Organet e Shoqërisë

- 7.1 Organet e Shoqërisë janë:
- Asambleja e Përgjithshme;
 - Administratori;

NENI 8 Asambleja e Përgjithshme



8.1 Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimarrës i Shoqërisë dhe përbëhet nga Ortakët themelues të saj apo Ortakët që mund të hyjnë më vonë në Shoqëri, përmes pjesëmarrjes në Kapitalin e Regjistruar të saj.

8.2 Cdo Ortak ka të drejtë të marri pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme.

8.3 Cdo Ortak në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, ka të drejta vote në përpjestim me vlerën nominale të kuotës së tij.

NENI 9

Emërimi dhe Kompetencat e Administratorit

9.1 Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë individ në pozitën e Administratorit të Shoqërisë. Administratori mund të zgjidhet nga rradhët e Ortakëve të Shoqërisë ose jashtë saj.

9.2 Afati i emërimit të Administratorit nuk mund të jetë më i gjatë se pesë vjet, me të drejtë rizgjedhje.

9.3 Administratori i Shoqërisë “Adriatic Luxury Hotels” Shpk, emërohet Z.Hauard Malo, për një afat 5 vjeçar, me të drejtë rizgjedhje. Afati 5 vjeçar fillon nga Data 06 . 06 .2023 deri me Datë 06 . 06 .2028.

NENI 10

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

10.1 Për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që mund të lindin në lidhje me interpretimin apo zbatimin e këtij Akti Themelimi, kompetente do të jetë Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë.

10.2 Për mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet Shoqërisë dhe Ortakëve të saj, kompetente do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

ORTAK THEMELUES

Shoqëria “Met Invest” Shpk

Administrator
Hauard Malo

Shoqëria “K & R” Shpk

Administrator
Osman Kokoshi

Shoqëria “Albanian Investment Construction

Administrator
Alban Peza

Ky Akti Themelimi përbëhet nga 3 faqe dhe nënshkruhet në dy kopje origjinale me vlerë të njëjtë, në Tiranë, sot më Datë 06 . 06 .2023

